

E nderuar Drejtoreshë e USAID-it për Shqipërinë, Znj. Meredith,

Të nderuar pjesëmarrës

Realizimi i kësaj tryeze të rrumbullakët nuk përbën thjesht një aktivitet të rradhës, por përfaqëson një moment të rëndësishëm të paraqitjes së instrumentave që janë projektuar dhe që kanë filluar të aplikohen, me synimin e rritjes së transparencës tek shoqëria civile dhe tek publiku i gjërë, por jo vetëm. Përfitimi nga përdorimi i teknologjisë së informacionit, për të identifikuar transaksionet me risk më të lartë potencial në procedurat e prokurimit publik ndikon në rritjen e efijencës dhe impaktit të aktivitetit auditues të KLSH-së.

Gjatë këtyre viteve 2012-2018 të procesit të modernizimit të institucionit, jemi përpjekur të fusim në auditim teknika të reja të vizualizimit të të dhënave, për të përcaktuar më mirë zonat dhe autoritetet kontraktore publike me risk më të lartë. Për ta realizuar këtë qasje, kemi bashkëpunuar me OJF dhe institucione prestigjioze të fushës. Pikërisht përbërja e kësaj tryeze të rrumbullakët është një nga treguesit e këtij rrugëtimi.

Mbështetja dhe kontributi i popullit dhe Qeverisë Amerikane, nëpërmjet Agjensisë USAID është sa unikal aq edhe i rëndësishëm për fuqizimin e institucioneve të pavarura të Shtetit Shqiptar, ndërtimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të administratës sonë publike, fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile, zhvillimin e sektorit privat, reformën zgjedhore, reformën administrative e territoriale dhe së fundmi dhe kryesoren, reformën në drejtësi.

Por në mënyrë specifike do të adresoj vlerën e shtuar të Projektit “Transparenca në sistemin shëndetësor” 2017-2019, i financuar nga USAID, i drejtuar me profesionalizëm dhe përkushtim nga zj. Darcie Nilsen, të cilën e falenderoj në mënyrë të veçantë.

E kemi mirëpritur Projektin, duke e mbështetur dhe jemi përpjekur të bashkëveprojmë për të realizuar çdo produkt të tij, pasi ai vinte në momentin e duhur të procesit të modernizimit institucional të KLSH-së dhe sinergjizohej plotësisht me disa nisma të tjera të transparencës dhe drejtpërdrejtësisë së informacionit për publikun e gjerë që institucioni kishte ndërmarrë. Për më tepër, sektori i cili ishte në fokus të projektit përbën një sektor me rëndësi për jetën e qytetarit shqiptar.

Shërbimet në spitalet tona publike dhe shërbimi parësor shëndetësor publik janë në vëmendjen e qytetarëve tanë dhe në qendër të ankesave të tyre për keqfunksionim të sistemit, krahas denoncimeve dhe raportimeve të shumta nëpër media. Qytetarët presin përmirësim rrënjësor në efektivitetin dhe cilësinë e këtyre shërbimeve.

Projekti i USAID ka punuar me efektivitet për krijimin e një mjedisi më të përgjegjshëm për përdorimin e parasë publike në sektorin e shëndetësisë, duke forcuar institucionet mbikëqyrëse si Avokati i Popullit, ILDKPKI dhe KLSH, si dhe duke rritur bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe median.

Pas pak më shumë se një viti nga data e nënshkrimit me USAID-in të Memorandumit të Mirëkuptimit, më 3 Tetor 2017, për projektin “Transparenca në Sistemin Shëndetësor” dhe në paralel me nisjen e implementimit në KLSH të informatizimit të plotë të drejtimit menaxherial për auditimet, nëpërmjet sistemit të teknologjisë bashkëkohore “REV-Zone” të komunikimit elektronik dhe shpërndarjes së informacionit dhe detyrave (investim i vetë institucionit) për realizimin e auditimeve, nënvizojmë mbështetjen efektive, dobinë, vlerën e shtuar dhe perspektivën për aktivitetin tonë auditues të produkteve që Projekti na ka vënë në

dispozicion, në formën e katër instrumentave të rinj të teknologjisë së informacionit, si më poshtë:

### **1. Instrumenti sinjalizues “Famur i Kuq” Red flags**

Në zbatim të misionit kushtetues, KLSH realizon aktivitet auditues në entet publike, ku një pjesë e rëndësishme përfshin auditimin dhe vlerësimin e procedurave të prokurimit publik. Algoritmi Red Flags do të përdoret nga ne gjerësisht për vlerësimin dhe skanimin e procedurave të prokurimeve. Ky algoritëm do të analizojë bazën e të dhënave ku vendosen procedurat e tenderimit dhe do t'i klasifikojë ato automatikisht në problematike ose jo. Në këtë mënyrë ai do të na mundësojë indicie në kohë reale mbi procedura me probabilitet për sjellje të papajtueshme me kuadrin ligjor apo mos respektimin e kornizës anti-korrupsion.

Ky instrument i zhvilluar në kuadër të Projektit mundëson filtrim të detajuar të procedurave në bazë të fushave të ndryshme si: Autoriteti Prokurues, Institucion Tenderues, Operator Ekonomik Kontraktues, Vlera/Fondi Limit, Statusi i Tenderit, Lloji i Kontratës Publike, Lloji i Procedurës, Data e Njoftimit të Tenderit, Data e Mbajtjes së Tenderit etj.

Kategoritë që janë përzgjedhur nga instrumenti si kategori problematike në rastin e procedurave të tenderimit në fushën e shëndetësisë janë:


- Mungesë Konkurrence
- Mungesë Gare, Negocim i Drejtpërdrejtë
- Pamundësi kohore për përgatitjen e një oferte
- Shtesë kontrate pa përfunduar faza e parë e kontratës
- Skualifikim i të gjithë operatorëve konkurues përveç operatorit fitues
- Anulimi i tenderit dy ose më shumë herë

Secila procedurë tenderimi do të na japë informacion të plotë të pasaportës së tenderit, përfshirë numrin e operatorëve konkurues, fondin limit, ofertën fituese në lekë pa TVSH, datën e shpalljes së fituesit, datën e lidhjes së kontratës, kohëzgjatjen e kontratës, ankesa nëse ka patur dhe link për aksesimin e dokumentave si Njoftimi i Tenderit, Specifikimi Teknik etj

The screenshot shows the openprocurement.al website interface. At the top, there are navigation tabs: Tender, Koncesion, Rreftage, Institucione, Kontraktues, Përkufizime, Projekti, and Tenderi Bazëri. Below these are search filters for 'Kategoria Rreftage' and 'Zgjidh kategorinë rreftage'. There are also filters for 'Autoriteti Prokurues', 'Institucioni Tenderues', and 'Operatori Ekonomik Kontraktues'. A bar chart titled 'Tendera me rreftage me vlerë mbi 100 milion lekë' shows the number of tenders from 2009 to 2017, with a final bar for 'Tre mujori i tretë 2018'. The chart shows a general upward trend in the number of tenders over the period.

## 2. Trajtimi dixhital i Ankesave të qytetarëve


Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vijuar të trajtojë me korrektësi dhe profesionalizëm **letrat dhe ankesat e qytetarëve**, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit. Duke u nisur nga filozofia e rolit aktiv, edhe në këto raste KLSH i ka orientuar qytetarët, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet t’i drejtohen, për të marrë përgjigje për shqetësimet e tyre, duke iu adresuar me komunikim zyrtar njëkohësisht edhe institucioneve përkatëse.



Duke marrë në konsideratë numrin e lartë të ankesave drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, jo vetëm me postë zyrtare por edhe nëpërmjet portalit zyrtar, në kuadër të Projektit u dakordësua zhvillimi i mekanizmit të ankesave.

Ky mekanizëm pranon ankesa nga qytetarët, të cilët duhet të plotësojnë të gjitha fushat e informacionit. Në këtë mënyrë shmangen ankesat anonime, të cilat mund të jenë pa përmbajtje ose mund të përmbajnë supozime të përgjithshme të pabaza për t’u shqyrtuar më tej.

Ky mekanizëm është testuar dhe do të implementohet në faqen zyrtare të KLSH, duke rritur transparencën jo vetëm kundrejt qytetarit, por edhe brenda institucionit.



Qytetari do të mund të marrë informacion në portalin tonë mbi statusin e ankesës së tij shumë me shpejt se deri më sot, nëse ankesa është në shqyrtim, është jashtë kompetencës së institucionit apo është zgjidhur.


Punonjësi i KLSH do të njoftohet me email automatik për ankesat që dërgohen nga qytetarët dhe do të mund aksesojë listën e plotë të ankesave, dokumentat që mund të ketë zgjedhur qytetari t'i bashkëngjisë rastit të tij si dhe të pasqyrojë përgjigjen përfundimtare të rastit në momentin që zgjidhet. Gjithashtu, punonjësi mund të shkarkojë në format excel listën e ankesave për të nxjerrë më tej statistika për raporte të ndryshme.

### 3. Instrumenti për publikimin e raporteve në formatin “Open Data”

Aktualisht vendimet dhe raportet e auditimit të institucionit publikohen në website-n zyrtar në format PDF, format i cili vështirëson nxjerrjen e të dhënave për përdorim të mëtejshëm. Publikimi i raporteve në instrumentin e zhvilluar me ndihmën e Projektit të USAID do të na mundësojë një paraqitje më koncize dhe më të lexueshme të objektivave dhe konkluzioneve të auditimeve, për të gjithë nivelet e qytetarëve të interesuar apo median.

Në këtë instrument, krahas publikimit të raporteve sipas kategorive Performance, Rregullshmërie, Teknologjie Informacioni apo raporte vjetore, ato do të klasifikohen dhe sipas fushave të ndryshme si Shëndetësi, Arsim, Financë, Qeverisje Lokale etj.

Një raport auditimi në këtë instrument është menduar të përmbajë informacion për ‘Kontekstin e Problemit Social’, ‘Subjektet nën Auditim’, ‘Objektivi i Auditimit’ dhe ‘Konkluzionet’. Krahas kësaj përmbledhjeje, bashkëngjitur do të vendoset raporti i plotë si dhe dokumente të tjera me të dhëna që janë përdorur në raport në formë tabelash apo grafikësh/imazhesh. në formë të aksesueshme nga publiku.



#### 4. Instrumenti “Data Mining”

Transparenca e aktivitetit të KLSH-së është një nga aspektet e funksionimit të institucionit tone, bazuar në standardin e INTOSAI-t, ISSAI 12 “si institucion që udhëheq nëpërmjet shembullit”, si dhe përbën një nga objektivat e Strategjisë së komunikimit të institucionit.

Qasjen e komunikimit të pandërprerë me qytetaret, KLSH e ka parë në këto shtatë vite 2012-2018, kryesisht nëpërmjet bashkëpunimit dhe partneritetit me shoqërinë civile dhe me median, si dhe nëpërmjet përgjigjeve me korrektesë ndaj letrave të qytetarëve. Instrumenti “Data Mining[dejta majning]”, krahas qasjes “Big Data[big dejta]”, duke shfrytëzuar edhe qasjen e SAI-t të Çekisë, në veçanti eksperiencën e gjerë të sjellë nga Presidenti i SAI-t çek, Ing. Miroslav Kala, zvKryetar i EUROSAT-t, në bisedën me audituesit e KLSH në gusht 2017 lidhur me menaxhimin e fluksit të informacionit elektronik qeveritar, do të na mundësojë nxjerrjen e të dhënave të ndryshme nga baza të dhënash të jashtme. Një nga strategjitë e informimit të publikut të përdorur nga KLSH, që në fakt është një eksperiencë unike, konsiston në prezantimin në media me artikuj të përgatitur nga audituesit tanë, artikuj në gazeta apo portale të ndryshme, bazuar në gjetjet me interes publik dhe rekomandimet e raporteve të auditimit.

Ky proces do të mundësojë nxjerrjen e të dhënave të ndryshme nga mediat online, si artikuj të përgatitur nga stafi i KLSH, apo që citojnë gjetje të auditimeve të KLSH-së. Ai bazohet në fjalë kyçe në fokus të KLSH si efektivitet, eficiencë, ekonomikitet, dëm ekonomik, auditim, të ardhura të munguara, përmirësime ligjore etj.

Ky instrument është vendosur në portalin zyrtar [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al) dhe do të aksesohet për një afat të papërcaktuar, pavarësisht së çfarë zgjedhin të bëjnë mediat online me artikujt origjinalë.

Është fakt që asistencë teknike që projekti “Transparenca në sistemin shëndetësor” i USAID ka ndikuar në përmirësimin e auditimeve tona të performancës në sektorin e shëndetësisë, në rritjen e aksesit të qytetarëve tek informacioni, futjen e disa zgjidhjeve teknologjike për sistemin e ankesave nga qytetarët, si dhe përdorimin me efektivitet të të dhënave të hapura dhe treguesve të alarmit të kuq “red flags” për fusha me risk të lartë për korrupsion. Gjatë dy viteve të fundit, kemi zhvilluar auditimin e performancës në Shërbimin e Urgjencës Mjekësore në Shqipëri, në Kostimin e Shërbimeve Spitalore dhe në Recetën Elektronike Mjekësore, krahas auditimit në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor.

Qeveria e SHBA-ve dhe institucioni zbatues i parave të taksapaguesve amerikanë për asistencë dhe zhvillim, USAID-i janë të investuar fuqishëm në të ardhmen e integritit evropian të Shqipërisë. Kjo e ardhme mund të realizohet me sukses vetëm nëpërmjet zbatimit të reformës në drejtësi dhe reformimit rrënjësor të administratës publike. Si reforma në drejtësi dhe reforma e thellë në administratën publike janë dy anë të së njëjtës gjë, të ndërtimit të Shtetit të së Drejtës në Shqipëri. Në shërbim të thellimit të llogaridhënies së administratorëve publikë, gjatë këtyre viteve kemi rekomanduar me forcë përgatitjen dhe miratimin e Ligjit për Përgjegjësinë Materiale të Nëpunësit Publik dhe do të vijojmë ta kërkojmë edhe në të ardhmen.

Ka shumë vlerë që ndërtimi i Shtetit të së Drejtës të fillojë edhe në një nga bazat e shërbimeve publike, sikurse janë shërbimet shëndetësore. Ne besojmë fort se qeverisja e përgjegjshme në sektorin e shëndetësisë, si kudo në shërbimet publike dhe në administrimin e parave të taksapaguesve shqiptarë, mund të sigurohet vetëm nga një bashkëpunim i sinqertë i Qeverisë dhe Ministrisë përkatëse, duke pranuar kontributin e institucioneve të pavarura si mbikqyrës kushtetues, të shoqërisë civile, të medias dhe të donatorëve e partnerëve tanë Perëndimorë, si dhe duke zbatuar rekomandimet nga gjetjet e tyre.

Ju faleminderit!